



100 Vjet Shtet Shqiptar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë, Tel: 2 270 630, Fax: 2 270 627 www.moe.gov.al

Nr prot 85

bl 7.01.2013

UDHËZIM

Nr. 1, datë 7.01.2012

PËR KËRKESAT MINIMALE PËR HARTËZIMIN STRATEGJIK TË ZHURMËS

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 1, të nenit 21 të ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis";

UDHËZOJ:

1. Përgatitjen e hartave strategjike të zhurmave të shkaktuara nga trafiku rrugor, hekurudhor, ajror dhe zonat me aktivitet industrial, përfshirë këtu edhe portet, sipas kërkesave minimale të vendosura në aneksin bashkelidhur këtij udhëzimi..
2. Hartat strategjike të zhurmave do të përdoren për sigurimin e të dhënave, për sigurimin e informacionit për qytetarët, si edhe për hartimin e planeve të veprimit.
3. Hartat strategjike të zhurmës duhet t'i paraqiten publikut sipas menyrave të paraqitura në pikën 2, të aneksit bashkëngjitur.
4. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe organet e pushtetit vendor.
5. Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Fatmir MEDIU

MINISTRI



ANEKSI 1

KËRKESAT MINIMALE PËR HARTEZIMIN STRATEGJIK TË ZHURMËS

1. Një hartë strategjike e zhurmës është paraqitja e të dhënave në një nga aspektet që vijojnë:

- një gjendje ekzistuese, e mepareshme ose e parashikuar e zhurmës, e shprehur nga një indikator i saj;
- tejkalimi i një niveli të lejuar (kufi);
- numri i banesave, shkollave dhe spitaleve në një zonë të caktuar të cilat ekspozohen në vlera të caktuara të një indikatori të zhurmës;
- numri i njerëzve të lokalizuar në një zonë të ekspozuar ndaj zhurmës.

2. Hartat strategjike të zhurmës mund t'i prezantohen publikut si:

- skica grafike;
- të dhëna numerike në tabela;
- të dhëna numerike në format elektronik.

3. Hartat strategjike të zhurmës për qendrat e banuara duhet te perqendrohen vecanerisht ne zhurmat e leshuara nga:

- trafiku rrugor;
- trafiku hekurudhor;
- aeroportet;
- zonat me aktivitet industrial, përfshirë këtu edhe portet.

4. Hartezimi strategjik i zhurmës do të përdoret për këto qëllime:

- për sigurimin e të dhënave që i dërgohen Agjencisë Europiane të Mjedisit;
- si një burim informacioni për qytetarët;
- si një bazë për planet e veprimit.

Secila nga pikat e paraqitura me lart kërkon një lloj të veçantë të Hartës Strategjike të Zhurmës.

5. Kërkesat minimale për hartat strategjike të zhurmës sa i përket të dhënave që duhen dërguar në Keshillin Teknik të Zhurmave (KTZH) janë:

5.1 Numri i përafërt i njerëzve (në qindra) që jetojnë në banesa të cilat i ekspozohen secilit nga këto grupe vlerash L_{dmn} në dB, 4 m mbi tokë, në fasadën më të ekspozuar: 55-59, 60-64, 65-69, 70-74, >75, vec për zhurmen nga trafiku rrugor, hekurudhor apo trafiku ajror, dhe nga burimet industriale. Shifrat duhet të rrumbullakosen në qindshet me te aferta (p.sh. 5.200 = mes 5.150 dhe 5.249; 100 = mes 50 dhe 149; 0 = me më pak se 50).

Veç kësaj duhet të thuhet, ku është e përshtatshme dhe ka të dhëna të tilla, sa persona të kategorive të mesiperme banojnë në banesa që kanë:

- Izolim special kundër zhurmës në fjalë, e cila nënkupton lloje të veçantë izolimi kundër një sërë burimesh të zhurmës mjedisore, kombinuar me sisteme të tilla ventilimi apo të ajrit të kondicionuar që synojnë realizimin e cilesive të larta të izolimit,
- Një fasadë e qetë, nënkupton fasadën e ndërtimit ku vlera e L_{dmn} 4m mbi tokë dhe 2m para fasadës, për zhurmë të emetuar nga një burim i caktuar, arrijnë vlera së paku 20dB më të ulta se në pikën e fasadës me vlerë më të lartë të L_{dmn} ,

5.2 Numri i përafërt i njerëzve (në qindra) që jetojnë në banesa të cilat i ekspozohen secilit nga këto grupe vlerash L_{nat} në dB, 4 m mbi tokë, në fasadën më të ekspozuar: 50-54, 55-59, 60-64, 65-69, >70, vecas për zhurmen nga trafiku rrugor, hekurudhor apo trafiku ajror, dhe nga burimet industriale.

Përveç kësaj, në rastet ku kjo është e përshtatshme dhe ka të dhëna të tilla, duhet paraqitur edhe numri i njerëzve nga kategoritë e lartpërmendura që kanë:

- izolime speciale kundër zhurmës në fjalë, si është definuar në paragrafin 5.1;
- fasadë të qetë si është percaktuar në paragrafin 5.1

Gjithashtu duhet paraqitur se si rruget, hekurudhat dhe ai aeroportet kryesore kontribuojnë në situatat e lartshënuara.

5.3 Numri i përafërt i njerëzve (në qindra) që jetojnë jashtë aglomerateve në ndërtime të cilat i ekspozohen secilit nga këto grupe vlerash L_{dmn} në dB, 4 m mbi tokë, në fasadën më të ekspozuar: 55-59, 60-64, 65-69, 70-74, >75.

Përveç kësaj, nëse është e nevojshme dhe ka të dhëna të tilla, duhet të jepet edhe numri i njerëzve nga kategoritë e lartpërmendura që kanë:

- Izolime speciale kundër zhurmës në fjalë, si është përcaktuar në paragrafin 5.1,
- Fasadë të qetë si është përcaktuar në paragrafin 5.1.

5.4 Numri i përafërt i njerëzve (në qindra) që jetojnë jashtë qendrave të banuara në ndërtime të cilat i ekspozohen secilit nga këto grupe vlerash L_{nat} në dB, 4 m mbi tokë, në fasadën më të ekspozuar: 50-54, 55-59, 60-64, 65-69, >70, ndaras nga zhurma nga rrugët, hekurudha apo trafiku ajror, dhe nga burimet industriale.

Përveç kësaj, në rastet ku kjo është e përshtatshme dhe ka të dhëna të tilla, duhet përfshirë edhe numri i njerëzve nga kategoritë e lartpërmendura që kanë:

- Izolime speciale kundër zhurmës në fjalë, si është përcaktuar në paragrafin 1.5,
- Fasadë të qetë si është përcaktuar në paragrafin 1.5.

5.5 Madhësia totale e zonës (në km^2) që i ekspozohet vlerave L_{dmn} më të larta se 55,65 dhe 75 dB. Duhet dhënë edhe numri i përafërt i të gjitha ndërtimeve (në qindra) dhe numri i përgjithshëm i njerëzve (në qindra) që jeton në secilën nga këto zona. Këto shifra duhet të përfshijnë qendrat e banuara.

6 Për informimin e qytetareve dhe për zhvillimin e planeve të veprimit duhet të jepet informacion shtesë dhe me i detajuar, i tillë si :

- një paraqitje grafike;
- harta që paraqesin tejkalimin e niveleve të lejuar (kufi);
- hartat e ndryshimeve, ku gjendja aktuale krahasohet me situata të ndryshme, mundësisht të së ardhmes;
- harta që tregojnë vlerën e një indikatorit të zhurmës në një lartësi të ndryshme nga 4 m atje ku është e mundshme.

7 Hartat strategjike të zhurmës për zbatimin e planeve lokale dhe kombetare duhet të behen për një lartësi vlerësimi prej 4m dhe për rang prej 5 dB për $L_{ditë}$ dhe $L_{natë}$.

8 Për qendrat e banuara duhet të hartohen harta të vecanta strategjike për zhurmën e shkaktuar nga trafiku rrugor, trafiku hekurudhor, trafiku ajror, zhurmat industriale si dhe nga aktivitetet e rekreacionit (pub, diskoteka, klube nate).